

Iniciativa Ndërinstitucionale për Zgjidhje të Qëndrueshme për Personat e Zhvendosur nga Kosova

Përmbledhje

Pse?

Një proces rajonal i domosdoshëm për mbështetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova për të lehtësuar zgjidhjet e qëndrueshme, përfshirë kthimet dhe integrimin lokal të personave të zhvendosur nga Kosova, përmes identifikimit të çështjeve dhe veprimeve të përbashkëta për të gjetur zgjidhje.

Kur?

Në vitin 2014, OSBE-ja dhe UNHCR-ja mbështetën Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK) për të nisur një proces rajonal me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova.

Kush?

Institucionet relevante nga Prishtina, Beogradi, Shkupi dhe Podgorica rregullisht takohen në kuadër të një procesi rajonal, i cili njihet si "Procesi i Shkupit". Përmes forumit të nivelit të lartë të themeluar me anë të këtij procesi, politikanë të nivelit të lartë takohen në baza vjetore për të rënë dakord mbi propozimet e Grupit Teknik të Punës, i themeluar për të zhvilluar dhe zbatuar zgjidhje për këta persona të zhvendosur. Institucioni kryesor përgjegjës për këtë proces në Kosovë është Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), sepse detyrat e saj përfshijnë zhvillimin e politikave, si dhe promovimin dhe zbatimin e legjislacionit për promovim dhe mbrojtje të të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer.



Fushëveprimi


Fushat prioritare dhe Masat:

- ✚ Dokumentet Personale
- ✚ Siguria, dialogu dhe reintetgrimi
- ✚ Menaxhimi i të Dhënave
- ✚ Zgjidhjet e qëndrueshme
- ✚ Të drejtat pronësore

Pas konferencës së parë në Shkup, e cila u zhvillua në nëntor të vitit 2014, në vitin që pasoi Grupi Punues Teknik për Zgjidhje të Qëndrueshme për Personat e Zhvendosur nga Kosova (GPT), i themeluar nga institucionet pjesëmarrëse në Procesin e Shkupit, u takua disa herë dhe finalizoi një sërë dokumentesh të cilat udhëzojnë krijimin, koordinimin dhe planifikimin e Procesit të Shkupit, fushat dhe masat që duhet të trajtohen si prioritete në kuadër të këtij procesi, si dhe fushëveprimin dhe modalitetet për bashkëpunimin teknik. Këto dokumente u miratuan zyrtarisht nga Forumi i Nivelit të Lartë. Në të njëjtin vit, një grup dokumentesh ku përfshihen pikat e veprimit u zhvilluan nga Grupi i Punës dhe u miratuan nga Forumi i Nivelit të Lartë. Dokumentet përshkruajnë veprimet që duhet të ndërmerren në secilën fushë tematike (E drejta pronësore; Dokumentet personale; Dialogu, siguria dhe ri-integrimi; Menaxhimi i të dhënave; dhe Planifikimi i zgjidhjeve) që duhet të zbatohen nga institucionet pjesëmarrëse.

Mekanizmat e krijuar

Procesi i Shkupit - Takime të organizuara për koordinim



Forumi i Nivelit të Lartë (FNL), është një forum i përbërë nga përfaqësues të nivelit të lartë të institucioneve pjesëmarrëse, që ka për qëllim shqyrtimin e progresit të arritur në nivelin teknik dhe ofrimin e udhëzimeve dhe mbështetjes politike të mëtutjeshme. Që nga viti 2014, Forumi i Nivelit të Lartë është takuar katër herë. Vlen të përmendet se në Forumin e Tretë të Nivelit të Lartë të mbajtur në Beograd në qershor 2016, me anë të një komunikatë të përbashkët, u lansua faza e zbatimit të Procesit të Shkupit. Me këtë rast të gjitha institucionet ranë dakord të fillojnë zbatimin e veprimeve të përgatitura gjatë procesit.

Grupi Punues Teknik Rajonal (GPT) përbëhet nga këshilltarë të lartë nga institucionet pjesëmarrëse. GPT ka mbajtur 7 takime pune nga shtatori 2015 deri në maj 2018 me qëllim të funksionalizimit të masave dhe prioriteteve të miratuara nga Forumi i Nivelit të Lartë. Kjo ka rezultuar me zhvillimin e të drejtave të pronësisë, sigurisë, dialogut dhe ri-integrimit, menaxhimit të të dhënave dhe planifikimit të zgjidhjeve, të cilat më pas edhe janë miratuar nga institucionet pjesëmarrëse.

Niveli i Pristinës – Angazhimi institucional dhe organizativ
Ministria për Komunitete dhe Kthim
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministria e Financave
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Zyra e Kryeministrit
Policia e Kosovës
Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Zyra e Prokurorit të Shtetit
Agjensioni për Regjistrim Civil
Agjencia Kosovare e Pronës
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Agjencia e Statistikave të Kosovës
Zyra e Komisionerit për Gjuhë

Pesë nën-grupe tematike zbatuese në Prishtinë

("Nën-GPZ") korrespondojnë me Grupet Punuese Teknike të Procesit të Shkupit ('Siguria, dialogu dhe ri-integrimi', 'Të drejtat pronësore', 'Dokumentet personale', 'Menaxhimi i të dhënave' dhe 'Planifikimi i zgjidhjeve'). Këto grupe punuese përbëhen nga përfaqësues të institucioneve përkatëse të Kosovës dhe mbledhen rregullisht me qëllim të zbatimit të pikave të veprimit. GPZ-të kanë mbajtur **19** takime gjatë vitit 2017 dhe **5** gjatë vitit 2018.

SIGURIA, DIALOGU DHE RI-INTEGRIMI

'Udhëzuesi për reagim të mekanizmave të nivelit lokal ndaj incidenteve që kanë ndikim në komunitete' (PV-të 1.1-1.4) është zhvilluar nga GPZ, dhe MKK e ka ndarë këtë dokument me Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (më 17 janar 2018)

Pika e veprimit (PV) 'Përfshirja e përfaqësuesve të të kthyerve në takimet e Këshillave Komunale për Siguri të Komunitetit si praktikë e zakonshme' – është përfshirë në 'udhëzues' (PV 2.1)

Rritja e numrit të anëtarëve të komuniteteve në Policinë e Kosovës (PV 4.1 dhe 4.2 Siguria, dialogu dhe ri-integrimi): Policia e Kosovës ka shpallur konkurs të hapur për anëtarë të rinj në Policinë e Kosovës. Afati i fundit për aplikim është 10 maj 2018. OSBE-ja ka organizuar fushata për të informuar dhe inkurajuar komunitetet që të aplikojnë.

PV 3.4 Identifikimi i nevojave për CCTV. Janë identifikuar komuna e Pejës, Istogut dhe Klinës si komuna me nevojë të tillë. Projekti teknik është dizajnuar për fshatin Osojan të Istogut, fshat ky me numrin më të madh të të kthyerve dhe me numër të madh të incidenteve. Projekti do të lidhë këtë fshat me dy fshatra të tjerë të të kthyerve në afërsi. Nevojiten edhe 40,000 euro shtesë.

PV 5.1 dhe 5.2; Një marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës, Zyrës së Kryeprokurorit dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për trajtimin e krimeve të urrejtjes

në Kosovë. Megjithatë, "të kthyerit" si kategori nuk është integruar në dokument. Modalitetet për interpretimin e kategorive do të diskutohen brenda grupit të punës.

PRONA

Lirimi i pronarëve nga radhët e personave të zhvendosur nga pagesa e tatimit të akumuluar gjatë periudhës që u është ndaluar qasja në pronë u miratua më 15 shkurt 2018 me dispozitën e futur në Ligjin Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në kuadër të nenit 39 (pronat e uzurpuara). (PV 3.1)

PV 5.2 Themelimi i një fondi për zbatimin e vendimeve të AKP-së për rrënimin e ndërtimeve të paligjshme: Në vitin 2017 AKKVP-ja inicioi një udhëzim administrativ për qartësimin e procedurave të rrënimit, i cili u shqyrtua në takimin e pestë të GPZ-së të vitit 2017 për t'u punuar më tej nga agjencia. Kjo çështje është ende në pritje.

PV 5.1 Krijimi i një fondi kompensimi për pretendimet e A&C: Në vitin 2017, 300,000 euro janë ndarë për kompensimin e rasteve ndërsa 300,000 të tjera janë ndarë për vitin 2018. Një grup ligjor i punës i themeluar nga qeveria është në proces të hartimit të një udhëzimi administrativ për udhëheqjen e këtij procesi. GPZ në sesionin e pestë të grupit ka shqyrtuar dhe diskutuar rreth këtij drafti. Pritet që Grupi Ligjor i Punës (i mbështetur nga OSBE-ja) do të finalizojë UA-në në një punëtori që do të mbahet më 18-20 maj në Tiranë.

PV 4.1 Përfshirja e personave të zhvendosur si kategori për lirim nga taksat gjyqësore për prona të prekura nga konflikti. Ministria e Drejtësisë deri tani ka raportuar progres në lirimin e personave të zhvendosur nga pagimi i taksave gjyqësore. Është bërë ndryshimi i nenit 450 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore dhe janë paraparë ndryshime në legjislacion. Personat e zhvendosur sipas MD-së nuk janë paraparë në Ligj si kategori e posaçme, por MKK-ja dhe anëtarët e GPZ-së janë pajtuar të avokojnë për këtë kur ligji t'i nënshtrohet konsultimit publik.

PV 2.1 KPCVA - duke u bazuar në raportin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit (551/2017) qeveria vazhdoi me zhvillimin e një koncept dokumenti për të adresuar çështjen e ri-dëbimeve, ndër të tjera. Faza e konsultimit publik përfundoi më 15 janar 2018 dhe adresoi çështjet e dëbimeve të shumëfishta dhe vazhdimit të administrimit. Një koncept dokument për ndryshimin e ligjit është miratuar nga Qeveria, dhe këto ndryshime janë në pritje. Pritet që qeveria të ndryshojë ligjin deri në fund të vitit 2018.

DOKUMENTET PERSONALE

Grupi punues për dokumentet personale ka shqyrtuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë fushë, si dhe shqetësimet eventuale që mund të kenë personat e zhvendosur gjatë pajisjes me dokumente personale në Kosovë.

Fusha e regjistrimit të statusit civil dhe lëshimi i kartës së identitetit si dhe dokumenteve të udhëtimit është plotësisht e mbuluar me norma ligjore. Zgjidhjet janë në dispozicion për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë. Zbatimi i normave ligjore në fuqi, në raste të caktuara nuk adreson plotësisht nevojat e personave të zhvendosur dhe të të kthyerve, të cilët hasin në disa pengesa gjatë realizimit të së drejtës themelore të tyre për pajisje me dokumente.

Në mungesë të temave konkrete që kanë të bëjnë me çështjen e pajisjes me dokumente e që prekin personat e zhvendosur dhe të kthyerit potencialë, një letër iu është dërguar të gjitha delegacioneve me qëllim të të kuptuarit të çështjeve më të rëndësishme që duhet të adresohen. Në fund të dhjetorit 2017, vetëm njëri prej delegacioneve është përgjigjur në këtë letër dhe temat janë duke u shqyrtuar me institucionet relevante.

Çështjet e qasjes më të lehtë në shërbime dhe aplikim në zyrat e gjendjes civile do të përfundohen me udhëzimin e MKK-së në kuadër të udhëzimeve që rrjedhin nga Rregullorja 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhjet e Qëndrueshme.

MENAXHIMI I TË DHËNAVE

Termet e referencës për bazën e të dhënave të MKK-së janë hartuar, dhe një konkurs i hapur për zhvillimin e kësaj baze të të dhënave do të shpallet në gjysmën e dytë të vitit 2018.

Pas funksionalizimit të bazës së të dhënave, ajo do të administrohet nga MKK dhe aplikacionet online do të kanalizohen përmes Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim për verifikim paraprak të të dhënave.

Pas zhvillimit të bazës së të dhënave, MKK do të ofrojë trajnime teknike për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim.

UNHCR do të vazhdojë të veprojë si "përfaqësuese" për shkëmbimin e të dhënave në mes të institucioneve relevante deri në përfundimin e bazës së të dhënave të MKK-së dhe mbetet e përkushtuar për ta mbështetur MKK-në .

PLANIFIKIMI I ZGJIDHJEVE

Takimet dypalëshe pritet të shtohen dhe arritjet/rezultatet duhet të reflektohen në Shtojcën I për delegacionin e Prishtinës dhe delegacionet e tjera.

Profilizimi i të kthyerve bëhet nga UNHCR-ja në rajon. Janë identifikuar rreth 4,000 të kthyer të cilët kanë shprehur dëshirën për t'u kthyer, dhe për ta duhet të gjenden zgjidhje.

Gjatë periudhës vijuese do të zhvillohen takime me përfaqësuesit e institucioneve/organizatave të ndryshme me qëllim të përpilimit të informacionit të nevojshëm për krijimin e një harte të akterëve të përfshirë në procesin e kthimit dhe ri-integrimit

Grupi diskuton domosdoshmërinë për konferencën e donatorëve dhe për zhvillimin e strategjisë për mobilizimin e donatorëve në Kosovë dhe në nivel rajonal (shih procesin e Sarajevës).